



Planuar / Dorezuar Pitmijeno/Prodato Received / Delivery	27-06-2023	3	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	4944/2023		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.697/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbaitësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.697/2023 të datës 02.05.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rruga në Komunë të Deçanit, kundër/Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve-Thesarit të Kosovës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpallet **Jo kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.697/2023 e datës 02.05.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Lënda i delegohet për shqyrtim organit kompetent-Administratës Tatimore të Kosovës.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në pozitë Zyrtar i Lartë i Personelit në Komunën e Deçanit, Zyra e Pensioneve në Pejë në kuadër të Departamentit të Pensioneve të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve me datë 08.02.2023 ka nxjerr Vendim me të cilin i është njohur e drejta në Pension të Personave me Pa Aftësi të Përhershme prej datës 25.05.2022 në shumën mujore prej 100 Euro.

Ankuesi lidhur me këtë, përmes emailit të datës 10.03.2023 ka kërkuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes formularit të listës lirim nga tatimi në pagë, mirëpo nuk ka marr përgjigje, ndërsa më datë 07.04.2023 i është drejtuar me kërkesë Departamentit Ligjor të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve përmes të cilës kërkon interpretim lidhur me kërkesën për lirim nga tatimi në pagë, por nuk ka marr përgjigje, ndërsa më datë 07.04.2023 kërkesën për lirim nga tatimi në pagë e ka ripërsëritur në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, mirëpo nuk i është realizuar, kurse më datë 12.04.2023 i është drejtuar me kërkesë për interpretim Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Ankuesi më datë 02.05.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3985/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kërkuar që t'i njihet e drejta për lirim nga tatimi në pagë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.06.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokollit 4734/2023 për shtyrjen e afatit të vendosjes së ankesës së ankuesit për 10 ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj anese ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 3985/2023 e datës 02.05.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 08.02.2023 të Zyrës së Pensioneve në Pejë-Departamenti i Pensioneve; Kërkesën e datës 10.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve; Kërkesën nga lista e pagave e datës 01.03.2023; Kërkesën për interpretim e datës 07.04.2023; Dokument identifikimi i ankuesit; Kërkesën për pagesë retroaktive e datës 07.04.2023; Kërkesën për interpretim e datës 12.04.2023; Listën e pagave mars 2023 për ankuesin; Vendimin e datës 13.06.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesja dhe organi i punësimit ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi, **sepse:**

Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi me ankesën e datës 02.05.2023 nuk konteston ndonjë veprim apo mos veprim të institucionit ku punon përmes të cilit do të ishin cenuar ndonjë e drejtë që derivon nga marrëdhënia e punës që rregullohet me Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, por ankuesi me këtë ankesë pretendon që interesi i tij është cenuar sa i përket tatimit në burim apo tatimit në të ardhurat personale.

Andaj Kolegji i Këshillit, konstaton se meqë kjo çështje nuk është e rregulluar me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, atëherë me qëllim të shqyrtimit të kompetencës lëndore lidhur me ankesën e ankuesit lidhur me pretendimet ankimore të tij dhe referuar materies që ndërlidhet me lirimet nga tatimi në burim apo lirimin nga të ardhurat personale ju referuar

nenit 1 të Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, i cili përcakton se: *“Ky ligj vendos sistemin e Tatimit në të Ardhurat Personale në territorin e Republikës së Kosovës”*, ndërsa përjashtimi nga të ardhurat personale është paraparë me nenin 8 të këtij ligji, kurse lidhur me zbatimin e këtij ligji është nxjerr Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2016 për Zbatimin e Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, i cili me nenin 11 ka përcaktuar të ardhurat e përjashtuara nga të ardhurat personale dhe duke marr për bazë që dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për Administratën Tatimore të Kosovës dhe për të gjithë personat që janë në fushëveprimin e Ligjit Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale siç parashihet me nenin 2 të këtij udhëzimi, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 10 të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat është përcaktuar mënyra e nxjerrjes së vendimeve shpjeguese individuale, si rrjedhojë bazuar në dispozitat e cekura më lartë përcaktohet se Administrata Tatimore e Kosovës është organi përgjegjës dhe mbikëqyrës lidhur zbatimin e dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me tatimet duke përfshirë edhe tatimin në burim apo të ardhurat personale.

Nga të cekurat si më lartë Kolegji i Këshillit, duke shqyrtuar ankesën e ankuesit ndërlidhur me pretendimet e tij, në mbështetje të nenit 21 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Kompetenca lëndore e organit publik përcaktohet me ligj. 2. Nëse kompetenca lëndore për një çështje të caktuar nuk përcaktohet shprehimisht nga ligji apo është e pamundur të përcaktohet sipas natyrës të çështjes, organi publik i ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit përkatës material, do të ketë kompetencën lëndore mbi atë çështje”*, si dhe duke marr për bazë nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetencë të trajtoj ankesën e ankuesit lidhur me këtë pretendim, ngase kjo çështje rregullohet me legjislacionin e lartcekur dhe organ kompetent për trajtimin e kësaj çështje është Administrata Tatimore e Kosovës.

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesi lidhur me pretendimet e tij, rrjedhimisht Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Administratës Tatimore të Kosovës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.697/2023, datë 27/06/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

